

BIBLIOTEKA E

8JH-1  
—  
A41

GÜLE OKASTET

MIMOZA AHMETI

# Bëhu i bukur!



p o e z i

891.5 82-1

卷之三

884-1

1341

Mimoza  
Ahmeti

Bëhu  
i bukur!

poezi



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

*Redaktor*

**STAVRI DAJO**

DROM  
HOMA

stod

trudil

lesen

## Sytë e mi

Sytë e mi,  
sytë e mi,  
janë dy bjeshkë  
në dashuri!

Bebëz e errët  
ku hyn drita,  
është shtegu  
ku të prita!

Si e gjete  
atë shteg,  
të ma ndezësh  
qiellin krejt?

im e önd  
Mes qerpikëve  
të mi,  
shih dy bjeshkë  
në dashuri!

## Gjyshes

Sa shumë halle që ka shkuar  
po i mungon ditari.  
Të gjitha gjyshja i ka shkruar  
në rrudhat që i ka balli...

...  
Moj gjyshe,  
s'të paska fund dhembshuria!  
Moj gjyshe,  
gjithë këtë mall ku e mban?  
Kështu qenka puna,  
dhe frutave ëmbëlsia  
më e ëmbël u bëhet  
kur dielli i rrudh e i than...

*notat veft e gjas*

## Për një peizazh

Dy buzë  
s'më japid dot  
peizazhin e një dashurie.

Dy sy  
nuk më mjaftojnë  
gjithashtu.

Më duhet kroi,  
kroi i mendimit,  
që rrjedh nga lug' i buzës  
nën qiell të vështrimit...

## Hyrie

# Kruja

Ngrihen malet, hapen si xhokë,  
retë si qeleshe mbi kokë,  
tirqet e rrëpirës nga kjo tokë!

Shihni Krujën time!

Lahuria gjelbërohet gushës,  
dielli që nga mali i qesh fushës,  
në ullishtë fryn puhi e muzës!

Për ty, Kruja ime!

Netët përmbi kreshta kur rrëshqasin,  
mijëra drita e ndezin tallazin!  
Tërë pallatet me kala përngjasin!

Kjo është Kruja ime!

Mes qytetit mbi kalë Skënderbeu,  
thua paska dalë me vrull nga dheu!  
Për liri ndritka shpatës tehu!

E lirë Kruja trime!

## Leksion

Përjashtë gjithçka u mbyll papritur,  
ti emrin tim shkruan në dorë.  
Dhe ngjan sikur mbi gjithë botën  
do derdhet shiu këtë orë.

Më kot mundohesh... i vëmendshëm  
nuk mund të jesh dot kurrsesi;  
në trurin tënd ra shqetësimi  
si vetëtima në retë gri.

Po unë e qetë shënoj leksionin,  
pa ndier mëri për këto ré.  
Dhe më pëlqen që sot në mbrëmje  
flokëlagur të shëtisim ne.

## Ditë provimi

Ka diçka të veçantë dita e provimit,  
të papërsërithshme nga ditët e tjera.  
Fillojnë të këputen fijet e durimit  
kur i pavendosur pret te dera.

Futesh, tërheq tezën. Dora dridhet pakëz.  
Shkunden emocionet si thërrmija drite!  
Hej, provim i fundit që me ankth ke pritur,  
provim' i qershorit me hundë të djersirë!



Erdh' koha...

Erdh' koha të nisem në Veri të Atdheut,  
atje ku malet mbajnë kësulë të bardhë mbi  
krye,  
atje ku rrëth zjarrit, symëdhenj fëmijët,  
rrezëllijnë të urtë e të mençur  
si yje...

Ti do tē mbetesh këtu —  
vazhdimisht i plogët...  
Duke më quajtur «romantike që s'di  
ç'është jetë».  
Dhe mbrëmjeve tē dimrit do dëgjosh muzikë,  
për tē qindtën herë tē njëjtat kaseta...

Ndërsa unë kushedi në ç'vatër fshatare,  
duke ngrohur duart në gjuhëzat e flakëve,  
kur jashtë dëbora një metër e ca ka shtruar,

pikërisht atëherë,  
do të mendoj atë gjënë e mallkuar,  
e cila të rrëmbeu nga ditët e mia...  
Ti s'e di cila?!

Burokracia.

## Flur bore

Fluturza bore rendin —  
imca **ndijimesh.**  
E malli të merr,  
e nis një udhë kujtimesh...

E malli të merr  
për lodra e trille  
të një moshe tjetër.

Ta shkundësh të kaluarën  
si ky flur bore  
mbi letër!

## Vjeshtë

Drurët krahëhapur recitojnë  
poemën e vjeshtës fletërënë.  
Ndërsa ne të dy si në ëndërr shkojmë  
përdore zënë...

### Papritur

drurët heshtën,  
erë nuk fryn,  
në pyll-qetësi.

Ndaloi fymëmarrjen për një çast natyra,  
kur më puthe ti!

e.n

## Dimri

Dimri si Demosten  
nis ligjëratën e tij.  
Tendos gishtërinjtë pyll' i zhveshur  
në ekranin e syve të mi.

U shfaq si këmbë lejleku  
një vetëtimë midis resh.  
Mikrociklone fletësh  
era përfton në shesh.

Rrymë e ajrit të ftohtë  
shprish baluket mbi sy.  
Dimri vërtet është i fortë,  
por jo sa ne të dy.

e.p.  
p00391

Mbi taketuke pellgjesh  
shkrumi i vjeshtës dridhet,  
zemra shpërthen kraharonin —  
zog i djersitur që hidhet.

Dimri si Demosten  
shpalos ligjëratën-stuhi.  
Qesh i pakrehur qyteti  
me flokët e tij bojë gri!

## Fëmijëria

Kam qenë fëmijë i ndjeshëm —  
e brishtë si bari...

Më e pathyeshme se kulpra e egër!

Kokëfortë siç janë shkëmbinjtë e hirtë të  
Krujës,  
mademët historikë 500-vjeçarë.

Gjithmonë ëndërruese, një bimë dielli.

Thatime, me dy sy si dy thëllime.

Çdo ngjarje përjetoja,  
sado e parëndësi.

Dhe njerëzit e zakontë  
pa zhurmë i doja!

Në qenien time e gjithë bota dridhej!

Kërcelli trup hidhej nëpër lodra,  
pastaj në ëndrra

për të ardhmen  
kridhej...



## Për tokën

Një udhë e gjerë, e bitumuar  
deri në Dajt gjarpëron.  
Trupi i saj i harkuar  
kryeqytetin e përshkon.

Po sonte ne pëlqejmë, të dy,  
këtë lëndinë ... Po numërojmë  
yje në qiell, yje në sy  
dhe zemrën tokës ia dëgjojmë.

I dashur, ti më preke flokët,  
me zë të butë mbi gjoks më the:  
— Njeriu ka nevojë pér tokën  
sado bitum të shtrojë mbi dhë!

e. n

## Besomë

Besomë që ëndrrat  
i kam si sytë  
e mëdhenj.

Besomë që ditët  
më rrjedhin vrullshëm,  
lumenj.

Besomë që këngën  
s'mund të ma zgjonin trille të tjera  
vetëm kjo tokë e gurtë,  
rrahur nga dielli,  
era!

Besomë që supet  
i kam të lirë  
në dashuri!  
Të vetmit krahë  
që m'i pushtojnë  
ndodhen te ti!

## Tetor

Vjeshtë dhe udhët pijnë shira,  
më shumë se kurrë shkëputen gjethe...  
Kullojnë strehët dhe çatitë.  
Vështrim të artë dridhin taksitë.  
Diç mërmëris me veten time,  
ca këngë të njomura prej stine.  
Rrallohet mjegulla: njerëz, veshje...  
Hapet qyteti si buzëqeshje.

## Ne dhe ditët

Ditët tona me rroba të thjeshta:  
pantallona pune, këpucë të sheshta.  
Prarim i diellit thyer në flokë,  
pa cekur ende rrezet në tokë.

Ditët e jetës — sijeta të ashpra.  
Nga ashpërsia — gjithmonë më të pastra.  
Nga pastërtia — përherë të dëlira,  
ditët e jetës — të ndershme, të mira!

Ditët, orëgjatat — të lodhura  
në përqafime — të çlodhura.  
Nga vogëlushët — të mitura,  
kurrë fytyrëmërzon!

Hapësirë pa fund  
e dashurive të thella!  
Me besim për të ardhmen,  
tek e sotmja të mbjella!



Kush ecjen ditëve  
t'ua pushojë mund?  
Kush qëllimin e madh  
një çast na lëkund?  
Askush!  
Askurre!  
Askund!

trubol 51 — latvijas 101  
trubols 51 — sudrabs 61  
trubim 51 — rūzibējov 114  
trutisīmīri 131

## Mbrëmje

Shëtis qytetin e madh tutje-tej...  
Pallatet e bardha u ngajnjë vaporëve...  
Vaporë... dhe lëkunden në mugëtirë.

Ndërsa pylli i zhveshur  
pret si një ishull  
zemrat e zogjve në kraharore njerëzish!

## Gjithçka më kujtohet

Gjithçka më kujtohet qartë:  
netët e ftohta të dimrit.  
Dashuria jonë — një urë e zjarrtë  
ndezur në skaj të pyllit!  
Gjoni këndonte mbi degë të ngrira  
me zë të butë, i malluar!  
Hëna thërrmonte akull të bardhë  
mbi trupat tanë të qafuar.  
Për çudi nuk na bëhej të flisnim  
atë orë gjysmerrësirë.  
Heshtja e thellë e gojëve tonë  
dinte të fliste më mirë...

Të gjitha netët njëra pas tjetrës  
gjëmojnë ndaj natës së parë:  
Nuk është e mundur  
që mbi këtë botë  
të ecim ne të ndarë!

## Vizion

Ndodhet diku një fshat i largët,  
që sot në hartë e prek me gisht,  
me ato udhë të rrëpirta  
që i kam shkelur ëndërrisht.

Dhe janë atje ato fytyrëza  
që drojtur do më qeshin mua.  
Pranë bankës me dru lisi të fortë,  
me ndjenjë të butë do t'i dua.

Kur pas dritares dimërore  
dëbora jashtë do flokëtojë,  
dy sytë e mi një çast do humbin  
në ëndërrime gjithëfarësoj.

Do më kujtohen ditë të zhurmëta,  
mbrëmjet e ngrohta të Tiranës.  
Hapat e tij të shqetësuar,  
stacioni çift te rrugë e Lanës...

Gjithçka do duket e mahnitshme  
 si push i plepave në erë.  
 Dhe për të zbardhur krejt kujtesën  
 dëbora jashtë do bjerë, do bjerë...

Befas shkumësi do rrëzohet  
 si për të zgjuar gishtat e mi.  
 Diç do më thonë sytë e fëmijëve...  
 Oh, më e madhja ciltëri.

Dhe është diku një fshat i largët  
 që sot në hartë e prek me gisht!  
 Të ashpra profile grykash  
 që më thërrasin miqësisht!

## Zogj dimri

Ju zogj dimri —  
besnikë të diejve të rrallë të shkurtit!

Zgjoni qiejt e ngarkuar me shira.  
përlesheni me retë pér hapësira.

Puploshë të squllur,  
nuk ju mposhtën rrufetë.

Edhe në dimër  
s'i braktisët foletë!

## Midis meje dhe teje

Gjithçka u bë e qartë  
në thjeshtësi të ditëve.  
Midis meje dhe teje, Atdhe,  
është kjo rrugë:  
rruga e këngës  
që thotë të vërtetën,  
për të mos humbur qëllimin,  
vetveten!

**Ti nuk e di**

*bukud i urlaq*

Ti nuk e di pse unë e dua vjeshtën!

Qielli i saj merr forma shqetësimesh...

Gjethet e thata dyndin kryqëzata  
nga lindja e zjarrtë gjer te perëndimi...

**Shpirti i vjeshtës**

*s'është rob paragjykimi!*

## Bëhu i bukur!

Bëhu i bukur sonte!  
Dëbo grindjet, largimet dhe heshtjen e  
vrazhdë nga kujtesa.

Sillmë ndër mend mua.

Dhe veten!

Eja duke kënduar një këngë burri pér jetën!  
S'ka rëndësi se qysh, veç thuaja këngës trime,  
me një tufë èndrrash si tufë zogjsh  
hapur në mijëra drejtime!

Jo i vogël në shpirt,  
as i ngushtë!

Sonte  
të jesh i gjallë e i çlirë si natyra

dhe Njeri — zotërues i natyrës dhe vetes gjithmonë!

Të dua pranë! Kuptomë!

Kam etje për krahët e tu mbi supejt e mia,  
për çlodhjen e kokës sime në qafën tënde  
si në një qafë lisi!

Nuk të kërkon cektësia, por thellësia.

Të dua të ndershëm, të pakfjalë e të mençur;  
të lodhur nga puna, kurrsesi ngajeta!

Të jesh i pastër, të biesh erë ujë si guri!

Të pafund të dua, të kem ku të mas vetveten!

Të dua të fuqishëm, të më ngresh peshë gjithë  
c'jam — trup e ëndërr!

Që pastaj, kur të kthehem, pas mbrëmjes  
e gjer natën vonë, të shkruaj vargje  
shumë herë më të bukur e më të guximtë  
nga këta që shkrova.

basakë! basakë! basakë!

perjetësimt

## Vjen një stinë

Vjen një moshë që ti dashuron dhe  
dashurohesh,  
vjen një stinë që lidh lulet e fjalëve...  
Je ti atëherë fytyra e jetës,  
zog që këndon në pëllëmbë të fletës,  
buze që thërret buzën e dashur,  
dorë që pështjell dorën e ashpër...  
Truri që çliron mendime, emocion...  
Me Atdheun si shoku me shokun bisedon!

## Pseudoletrari

Letrar i ri u prezantove  
me idealin poetik.  
Vështroje kokën e Homerit  
të lashtë, të ftohtë si relikt.

I pari vit ishte atëher',  
i fundit po afron tani.  
Ndryshove ti në karakter  
dhe kjo t'u shfaq në poezi.

Qëllim për ty u bë botimi,  
grafiti mbushte dhjetëra fleta.  
Kuptimin jetës ia kërkoje, por...  
pa u nisur nga vetë jeta.

Dhe kur e emërimit kriza  
të dha sinjal në vit të tretë,

ti deklarove: «Seriozisht,  
jam gazetar, nuk jam poet!»

Braktise strofa, vargje, rima;  
nise të shkruash reportazh.  
Talentin poetik përzjeve  
me interesin — aliazh.

Nuk di në do të mbajë gazeta,  
Tirana s'di në do të mbajë.  
Por e di mirë: ty poezia  
nuk të pranon në front të saj!

# Tik-tik

Dy kapëse rrobash në telin  
me rruaza shiu..

Si dy zogj të veckël, era i tund.

Dy kapëse rrobash në dritaren time  
trokasin.

X Duart e nënës më vijnë ndër mend,  
kanotierat e fëmijërisë...

Tik-tik,  
dy zogj kauçuku  
prekin në qelq kujtimesh...

## Riviera

...Tarraca vigane në blloqe piramidalë.  
Faraoni do të stepej para tyre...  
Kore ullinjsh dhe komplekse agrumesh  
madhërisht këndojnë himn natyre!

Lart, në majëmajë, ku prek një re,  
sfurku i bujkut është korifë...

## Kryeqyteti

Gjerë e gjatë Tirana  
në truall pranvere shtrirë!  
Parqe, èndrra, fëmijë  
çelja i ka përpirë.  
Fjalët në gojë bëhen lule  
që marrin formën e buzës!  
**Trupi yt djaloshar**  
dihat nën cipën e bluzës!  
Derdhet kryeqyteti:  
njerez, zogj, pingërimë...  
Sytë e tu janë qielli  
i vetëdijes sime...

## Luftë

E ashpërjeta, në fronte e ndarë,  
në çdo moshë luftojmë dhe jemi ushtarë!  
Ti që s'do ta dish këtë luftë pa zë,  
do apo nuk do, je përfshirë në të!  
Nuk ka neutralë! Herët a vonë  
«Paqen me vetveten» zjarri ta shkatërron!  
Shkele kompromisin! Për qëllimin shkrihu,  
përmes kontradiktash rritet Njeriu!  
Bëhu atmosferë: ajër, diell, re,  
mate trupin tënd me trupin Atdhe!  
Luftë ështëjeta! Ne jemi ushtarë  
që nga prapavija gjer në front të parë!

## Ti mbetesh i ri

Një vijë-projekt rrudhë ra mbi ballin tënd  
dhe një thinjëz.

Njëzet vjeç ti je! Njëzet!

Ke jetuar, qeshur, lodhur e përtërirë  
20 vjet dhe 80 stinë...

Po ç'është vallë kjo për njerinë!

Një vijë në ballë

nuk e tremb dot jetën!

Pasqyra e dhomës s'mund ta gjejë të vërtetën!

Shihu në sytë e mi!

Gjersa ata derdhin çurkaja të blerta,  
ti mbetesh i ri! ...

Eci

Me cironka të shpejta mendimesh në kokë  
më pëlqen të eci...

Harroj urbanët, pasagjerët, stacionet,  
dua të eci!

Takoj t  dashurin. Kasketa i ka shkuar  
shtremb r!  
M  çukit nj  puthje n  faqe: — Eja t  ecim!  
T  ecim me nj  vog lush,  
q  s na arrin kup n e gjurit,  
p r k t   
posa filluam t   nd rrojm ...

Rover

Mendojmë për poetin arab të rrethuar  
90 ditë nga hiena izraelite!  
Mendojmë për botën, shekullin tonë  
që digjet me flakë të tejme!

Ecim...  
Mos pyesni për viset tonë...  
Stërgjyshi ynë i stërlashtë është ECJA!

# Revolte

Ta kushtoj ty, Xhoni,  
viktimë e kapitalit!

Xhoni nuk ishte send,  
send e kthyen Xhonin.  
Xhoni nuk ishte mall,  
mall e bënë Xhonin.

Xhoni s'ishte robot,  
paçka se punoi robot.  
Duart e tij konvejerin,  
një ditë  
nuk e mposhtën dot.

Xhoni... i mbetur pa duar  
«I pavëmendshmi Xhoni!»  
Cung i prerë, s'jep mbivlerë:  
«Marsh nga fabrika, Xhoni!»

Xhoni nuk ka më grushta  
për demonstratën e jetës!  
Revoltë, paditje në erë  
ngre cungjet e tij të prerë!

## Poezi-domosdoshmëri

Poezi e jetës,  
ty të thërras!  
Me fuqinë e fjalës  
sot dua të flas!

Erdhëm të dyja  
duke shkrirë në një:  
Ti më jep forcë,  
unë të hov zë!

Kaq herë me njëra-tjetrën  
në nerv jemi ngrënë!  
Po kurrë dot s'u ndamë,  
kurrë s'jemi lënë!

Mbi ne shpreh vullnetin  
domosdoshmëria

në lidhjen konkrete:

njeriu-poezia!

Dhe, derisa lufta,

të vazhdojë mbi dhë

shok të një betimi

të kam e më ke!

Poezi e jetës

ti më thërret

dhe është e pamundur

të mos jesh poet!

## Ëndërr dhjetori

Rruga me stola dhe parku,  
yjet të ndalur në drurë.  
Hëna fiksuar në qiell  
si në gravurë.

— Përse kaq e gjatë kjo heshtje?  
— E thyejmë, — më thua ti.  
Dhe dorën ma merr në duar  
me ngrohtësi.

— Do ndodhë apokalipsi,  
po të të puth një herë?  
— Nuk e besoj, — mërmërij  
dhe fjalët më dridhen në erë.

## Këndë e djeqotut

Rruja u step e çuditur!  
Yjet kuriozë në drurë...  
Të jetë ëndërr kjo natë?!  
Të jetë gravurë?!

## Kënga e gjeologut

Merre, malësore,  
një tas me qumësht  
e hidhja një shuk bore!

E bjerma ta pi  
atë freski  
bjeshke e livadhi!

Eja, malësore,  
push sytë e ballit,  
se sot u gjet minerali!

## Mushak Haxhia

Një bllok i murmë mbi shkëmbinjtë gri  
qëndron si bedenat mbi kala!  
Aty jehon Valbona me poterë,  
Mushak Haxhia n'ato gryka ra!

Me lotë shkume një natë Valbona  
qau deri vonë në agim.  
E ndjeu se do të binte hasmi,  
ndaj me jehonë dha kushtrim.

Mushak Haxhia me vëllezër t'vet  
me sy ia puthi thepin pushkës!  
Kësulë e bardhë nga malësia  
s'duroi dot njollën e krupës.

Pushkët kërkoi Veshoviçi,  
Mushaku s'i dha as tre gurë zalli!  
Nga breg' i Kikës topat villnin,  
çuhej oshëtimash mali.

Kollatës nga gjëmimi iu drodh mjekra,  
nëpër ahe gjylet shpellë hapnin!  
Turreshin gërdhatës dhitë e egra,  
plumbat zemra shkjav kapnin.

Gurët u nxinë nga kufomat,  
përreth më s'mbeti shenjë jetë!  
Po trupat tuaj, Mushak, skuqnin  
nga dhjetëra thika, bajoneta.

Përmbysëj grykave Valbona  
ndeziur nga gjaku derdhej pragjesh!  
U bë flamur me kilometër,  
flakë kushtrimi përmes Alpesh!

## Vdekja e korrierit

Mbi Moravë borëtoi nata  
dhe stuhi e verbër plumbash frynte.  
Plumbi e pushtoi në kraharor,  
kraharori i përgjakur ngrinte.

Nënë e tij pështetur ndanë vatrës  
me dy shtiza trikon i punonte.  
Ajo maste mëngët me kurrizin,  
tutje mbi Moravë borëtonte...

Nëna maste mëngët me kurrizin...  
Bora me qefin pështillte birin.

## Dua

Dua ta bëj këtë çast të ndjeshëm,  
të prekshëm ta bëj, ta kthej në valë!  
Dua që ky çast të thotë një fjalë...  
Një fjalë që i ka rrënjet

në thellësi të jetës:

**DASHURI!**

## Takim

## o k t o b e r

Qielli me gojë të bruztë ndjek diskun e ftohtë të hënës...

Qetësia e mbrëmjes mbi drurët e fjetur  
është jona.

I vetmi zog këtë orë mbetet fjala  
dhe buzët tonas...

## Dialektikë

m i d i t

Ka qindra vjet dhe përsëri,  
më shumë vazhdon t'i kërkojë jetës  
njeriu, fantazia e tij,  
prirur me gjak drejt së vërtetës!

Ky shekull, i njëzetë në radhë,  
në luftëraq rruzullimin dogj!  
Dy herë u bë bota gërmadhë  
e kjo, në thelb, ndërgjegjen poq.

Atë çka ëndërrojmë s'do presim  
ta sjellë rrjedha kohështruar!  
Mbi lodhjet që i përshëndesim  
ne Diellin pushtojmë me duar!

Ka mijëra vjet që njerëzimi  
më fort, më fort marshon drejt jetës!  
E historisë dialektika  
priret me gjak drejt së Vërtetës!

poq.

## **Ishte drita...**

Ti kishe vullnetin, pasionet e zjarrrta,  
materie e gjallë ti ishe!  
Erdhe tek unë. Unë të ngjaja ty  
dhe u bëmë dy!...

Mes meje dhe teje vërshoijeta  
me të gjitha fushat, tingujt, valët...  
Diçka i shqetësoi, i lëvizi të gjallët!

**Ishte drita...**

## **Qetësia**

Qetësia është...  
Të çlodh qetësia.  
Njeriu paska nevojë për të!

Qetësi e shurdhër është pritë!  
Qetësi e verbër të vret!

Vrull i jetës! Ti e mposht qetësinë pasive!  
Atdhe! Zgjero frysëmarrjen në kraharorin  
Botë e madhe! Shpalos degët e tua vigane  
në mendimet e mia!

Kjo është! Kjo është qetësia!

## Le tē jetē si tē jetē

Pasdreke sot lava rroba,  
duke kënduar e duke larë.

Thua këndoja me ritmin e duarve?  
Apo duart i bindeshin këngës sime?

Po... le tē jetē si tē jetē,  
puna me këngë ikën më lehtë...

## Mëngjesi

Mëngjesi qesh,  
u çel një portë.  
Dega e mollës  
mbi diell pret kordë.

Agimi hyri  
në dhomë  
si fëmijë.  
Dhe zgjoi gjumin tënd  
me doçkat e tij.

I ngrohtë u përshtete  
përmbi kurmin tim...  
Si mund të nisë dita  
pa një përqafim?

# Morfologji

110010

Përemrat pronorë, përemrat pronorë,  
i gjejmë këtu, na gjejnë atje!  
Prona nuk kemi, pronarë nuk jemi  
po prapë «përemra pronorë» themi ne.

.... e imja .... im...  
....e jotja ... yt...  
Morfologjia më lodh këtë orë...  
— Me leje, shokë, kam një mendim:  
përse mos t'i quajmë «përkatësorë»?

*Shap*

## Oborr

ijgolotioM

Ti s'je. Në oborr të kërkoj.  
Lëvizin studentët. Por ty nuk të gjej.  
Dikush qesh. Frymë e avullt del  
nga gjokset e ngrohta, buzët e kuqe...  
Sytë i lëviz. I lëviz shpejt.  
Por ti nuk qenke. Dhe është dhjetor!  
Bryma e kaltër më cipëron në mendje  
apo prania e mungesës tënde?

## «Cic-mic»

I njoh ca djem, nuk më vjen mirë  
për ta të shkruaj këtë fletë.

Po bëhen burra, por çudi,  
s'paskan kurajë të hyjnë në jetë!

Frëngjisht, anglisht apo gjuhë tjetër  
mësojnë të flasin, për kulturë.  
Interesant, të thjeshtën gjuhë  
të dashurisë s'e folën kurrë.

Jo pse nuk dinë ta ligjerojnë.  
Dhe jo se ndiejnë pasiguri,  
po i tërheq të praktikojnë  
lojën cic-mic në dashuri.

E marr, s'e marr, e lë, s'më lë,  
luhet cic-mic-i i pabesë.  
Pa lindur ende miqësia,  
e përcaktuar është të vdesë!

## Cicamic

Prej një xhaxhai me pozitë,  
nga «vjeħerr i ardħħshiem» n'akademij,  
tē përgjerojen: «Ty tē ndjej, shpirt!»  
Sugestionohen s'di se si.

Janē bérë mjesħtra tē cicmic-it,  
e luajnē hollē nē teh tē vesit;  
stoikē si Dombi para ndjenjave  
dhe Donzhuane pas interesit.

## Dhomë konviktij


Këtu gjithçka na është e njojur,  
e dashur është gjithçka!  
Këtu jetojnë sende të thjeshta  
dhe ëndrra të mëdha...  
*metakof*

X

# Teleg ram

Të dashur prindër,  
jam mirë,  
shokët — shëndoshë e mirë!  
Lodhja më bën të lumtur,  
puna më bën të lirë.

*per penes*  
*jeug*



## 30 qershori

tirana teku

Dritarekaltër mbenë konviktet.

Under qyteza pa njeri,  
të postës derë myll postierja...

Veç unë po rri,  
veç unë po rri...

Shokët u kthyen në qytete,  
dikush në fshat, në mal, kudo!  
Zemër e derdhur në Atdhe  
ishte kjo ditë  
e ikjes, kjo.

Si në një ishull qetësie  
shëtis këtu të vonat orë...  
Më nuk të shoh, qytezë e dashur,  
gjer në shtator,  
gjer në shtator!

## Ushtari

shop

ëton ëtA

## Poetja

Ti je kështjellë drite violet.

Ti je vjeshta mbushur me fletë.

Ti je era që nuk të shoh.

Nga vrulli i valës të ndiej, të njoh.

Ti je zemra e një zogu.

Ti je duhia e një troku.

Ti je besimi. Ti je vetëdija,  
ngjyra e flakës mbi malet e mia!

## Atë natë

Atë natë kishe lumin tim  
futur thellë brenda gjirit.  
Atë natë kishe edhe urën  
me harqet e përkuljes sime.  
Atë natë kishe fluturimet e mendimit tim.  
Atë natë kishe zemrën krisur  
në mijëra kokrra shege.  
Atë natë blunë e maleve kishim të dy...  
Atë natë besën për një legjendë  
i dhamë njëri-tjetrit...

## Lagja e fëmijërisë

Një vrap me pantallona të shkurtra —  
fëmijëria ime.

Krisma e kanaçes nëpër muzg...  
Shkulja e veshit kur s'doja mësime  
dhe ashpërsi e zërit «Nuk ke turp!».

Si vrapi im shkuan ato vite  
me lojëra topa-gropa, kukafshehthi.  
Rrugicë e dashur më dha një diell drite  
për qiellin e madh të një poeti!

X

U shkund, u shkund nga supet fëmijëria  
sì një lirikë e freskët n'ato pragje.  
Dhe në kumboftë plot jetë poezia,  
djepin e saj përkundi ajo lagje!

me

forja e rípa

o sacerdote e confessor oura grava de  
meu treinad

seu embaixado o mandado  
de meus pais mandado a mim  
que eu devo ser o seu escrivão

que eu devo ser o seu escrivão  
que eu devo ser o seu escrivão  
que eu devo ser o seu escrivão  
que eu devo ser o seu escrivão

que eu devo ser o seu escrivão  
que eu devo ser o seu escrivão  
que eu devo ser o seu escrivão  
que eu devo ser o seu escrivão

## P E R M B A J T J A

Hyrje .....	3
Kruja .....	4
Leksion .....	5
Ditë provimi .....	6 X
Erdh' koha .....	7
Flur bore .....	9
Vjeshtë .....	10
Dimri .....	11
Fëmijëria .....	13
Për tokën .....	14
Bësomë .....	15
Tetor .....	16
Ne dhe ditët .....	17
Mbrëmje .....	19
Gjithçka më kujtohet .....	20
Vizion .....	21
Zogj dimri .....	23
Midis meje dhe teje .....	24
Ti nuk e di .....	25
Bëhu e bukur! .....	26 X

Vjen një stinë .....	28
Pseudoletrari .....	29
Tik-tik .....	31
Riviera .....	32
Sytë e mi .....	33
Gjyshes .....	35
Për një peizazh .....	36
Kryeqyteti .....	37
Luftë .....	38
Ti mbetesh i ri .....	39
Eci... .....	40
Revoltë .....	42
Poezi-domosdoshmëri .....	44
Ëndërr dhjetori .....	46
Kënga e gjeologut .....	48
Mushak Haxhia .....	49
Vdekja e korrierit .....	51
Dua .....	52
Takim .....	53
Dialektike .....	54
Ishte drita .....	55
Qetësia .....	56
Lë të jetë si të jetë .....	57
Mëngjesi .....	58
Morfologji .....	59
Oborr .....	60
«Cic-mic» .....	61
Dhomë konvikti .....	63
Telegram .....	64

Ahmeti, M.

Bëhu i bukur! Poezi. [Red .S. Dajo]  
T., «N. Rrashëri», 1986

76 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891.983-1

**RECENSENTE:**

**Bardhyl Londo,**

**Klara Kodra**

Tirazhi 1000 kopje Format 70x 100/32 Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re  
Tiranë 1986